



AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PARTIA SOCIALISTE E DËRGON NË KUVENDIN E SHQIPËRISË PROJEKTREZOLUTËN KUNDËR RAPORTIT TË DICK MARTYT

PARTIA E EDI RAMËS NIS BETEJËN KUNDËR RAPORTIT TË DICK MARTYT

FAQE 4-5



Ashtu siç kishte paralajmëruar kryeministri i Shqipërisë dhe kryetari i Partisë Socialiste (PS), Edi Rama, në qershor të këtij viti, deputetët e partisë që drejton kanë nisur betejën kundër raportit të Dick Martyt. Njëmbëdhjetë deputetë të PS-së kanë dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë projektrezolutën kundër raportit

të Martyt, e cila, pasi ta marrë miratimin e deputetëve, do të dorëzohet në Këshillin e Evropës. Sipas kësaj projektrezolute, pretendimet e Martyt kundër liderëve të UÇK-së nuk janë vërtetuar asnjëherë. Në këtë dokument është kërkuar që Këshilli i Evropës të distancohet nga akuzat e Dick Martyt

OPINION

SPIUNËT E DYFISHTË, DUKURI NORMALE TË SHËRBIMEVE INFORMATIVE DHE KUNDËRINFORMATIVE! F. 6

Behxhet Sh. SHALA – BAJGORA



AKTUALE



SBASHK-u PARALAJMËRON GREVË TË PËRGJITHSHME PARA SHTATORIT F. 5

SVEÇLA: KOSOVA NUK KA LUFTËTARË NË UKRAINË F. 7

EKONOMI

SKEMA E RE E QEVERISË: ÇDO FAMILJE NJË ANËTAR TË PUNËSUAR F. 8

PKD-ja: SUBVENCIONIMI I PËRKOSSHËM I PUNËSIMIT, EKSPERIMENT I PANEVOJSHËM I QEVERISË F. 8



SPORT

MEDALISTËT E LOJËRAVE MESHETARE PRITEN NGA KRYEMINISTRI ALBIN KURTI F. 12



KOSOVA REGJISTRON DY VIKTIMA DHE MBI 600 RASTE TË REJA ME COVID-19

FAQE 5



IKD-ja: GJYKATAT NEGLIZHUAN RASTET E POLITIKANËVE I FAQE 3

RENOVA PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Rusia gjobit me 360 milionë dollarë kompaninë "Google"

Moskë, 18 KORRIK - Një gjykatë në Moskë ka gjobitur të hënën kompaninë "Google" me 21 miliardë rubla (360 milionë dollarë) pasi, sipas saj, nuk ka hequr përmbajtje në lidhje me ndërhyrjen ushtarake të Rusisë në Ukrainë.

Rregullatori i telekomunikacionit rus, "Roskomnadzor", deklaroi të hënën se platforma video "YouTube", në pronësi të "Google", dështoi në bllokimin e "informacioneve të rremë" mbi ofensivën ruse në Ukrainë, sikurse edhe në heqjen e "propagandës ekstremiste dhe përmbajtjeve terroriste" të cilat u bënë thirrje të miturve të merrnin pjesë në demonstrata të

paautorizuara.

Kjo është hera e dytë që autoriteti rus gjobit "Google"-n pasi vitin e kaluar gjiganti i telekomunikacionit botëror u gjobit me 98 milionë dollarë.

Llogaria bankare e filialit rus të "Google"-s u bllokua, çka solli falimentimin e saj dhe bëri të pamundur pagesën ndaj stafit dhe furnizuesve lokalë.

Kompania "Google", e cila mund ta apelojë vendimin, nuk i është përgjigjur ende kërkesës për koment.

Në qershor të këtij viti rregullatori rus i telekomunikacionit "Roskomnadzor" deklaroi se platforma "YouTube" po shpërndante informacion të

remë mbi konfliktin në Ukrainë dhe kishte lejuar promovimin e pikëpamjeve ekstremiste në vend. "Faqja e videove 'YouTube' me qëllim promovon shpërndarjen e informacioneve të pavërteta mbi progresin e operacionit special ushtarak në Ukrainë, duke diskretitur forcat e armatosura të Federatës Ruse", deklaroi Roskomnadzor.

Rusia pretendon se po zhvillon "një operacion special ushtarak" në Ukrainë, për të eliminuar, sipas saj, një kërcënim ndaj sigurisë dhe për ta mbrojtur popullsinë rusishtfolëse nga persekutimi.

Ukraina dhe aleatët e saj perëndimorë hedhin poshtë akuza të tilla si pretekste të pabaza



për një grabitje të paligjshme terroresh.

"Google" konfirmoi më 1 mars se kishte hequr mediet ruse të financuara nga shteti si "RT" nga

seksioni i saj i lajmeve, përfshirë mjetin e kërkimit të "Google News", pas pushtimit rus të Ukrainës, raporton agjencia e lajmeve "Reuters".

Greçia me notë proteste ndaj Serbisë lidhur me rrëzimin e avionit



ATHINË, 18 KORRIK - Greçia ka dorëzuar ankesë ndaj Serbisë të hënën pasi një avion ukrainas i mallrave që po bartte armë, u përplas tekta tentoi të bënte një aterrim emergjent në veri të Greçisë. "Ambasadori grek në Beograd është udhëzuar që të ankohet te qeveria serbe për ta theksuar nevojën që autoritetet greke të informohen paraprakisht për natyrën e ngarkesës së avionit", tha një zyrtar i qeverisë greke, i cili nuk dëshoi të identifikohet para se të

bëhej njoftimi zyrtar.

Tetë anëtarë të ekuipazhit të avionit të mallrave, që operohej nga një kompani ukrainase, u vranë pas rrëzimit të avionit të shtunën në Kavallë të Greçisë. Pas rrëzimit, ka pasur shpërthime të eksplozivëve për të paktën dy orë.

Autoritetet serbe thanë se avioni po bartte 11.5 tonë minahedhës dhe mina të tjera serbe për në Bangladesh. Avioni ishte paraparë të bënte një ndalesë në Aman të Jordanisë.

Ekipet e deminimit për të dytën ditë me radhë po punojnë në vendin ku u rrëzua avioni.

Avioni ukrainas i mallrave u rrëzua rreth 40 kilometra në perëndim të Aeroportit Ndërkombëtar të Kavallës.

Zëdhënësi i zjarrfikësve, Yiannis Artopios, tha se nuk janë gjetur substanca të rrezikshme në vendin ku u rrëzua avioni.

Ai shtoi se të gjithë anëtarët e ekuipazhit besohet se ishin ukrainas.

Britania: Rusia po kontraktonte mercenarë për luftën në Ukrainë

Londër, 18 korrik - Rusia po përdor kontraktorin privat ushtarak, Wagner, për ta forcuar ushtrinë e saj në pushtimin e Ukrainës, tha inteligjenca ushtarake britanike.

Në përditësimin ditë për luftën në Ukrainë, Ministria britanike e Mbrojtjes tha më 18 korrik se Wagner po ul standardet e rekrutimit dhe po punëson të dënuar dhe persona që janë në listë të zezë. Kjo, sipas Britanisë, potencialisht mund të ndikojë në efektivitetin e ushtrisë ruse.

Wagner besohet se kontrollon nga Yevgeny Prigozhin, një bashkëpunëtor i ngushtë i presidentit rus Vladimir Putin.

Ky njoftim i inteligjencës britanike vjen një ditë pasi kreu i forcave të armatosura të Britanisë, admiralit Tony Radakin, tha se Rusisë i kanë vdekur ose plagosur afër 50 000 ushtarë gjatë pushtimit të Ukrainës, ndërsa i janë shkatërruar rreth 1 700 tanke.

Duke u përballur me numër të lartë të viktimave në luftën në Ukrainë,

qeveria e Putinit dhe ushtria kanë ndërmarrë një sërë hapash për ta rritur rekrutimin e ushtarëve, tash për tash urdhëruar mobilizim të përgjithshëm që mund të ketë rrezeqe politike.

Autoritetet ukrainase kanë paralajmëruar se Rusia ka humbur mbi 38 450 ushtarë dhe oficerë qëkur nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt. Ministria e Mbrojtjes e Rusisë për herë të fundit ka publikuar në mars shifrat e të vdekurve, duke pranuar se i janë vrarë 1 351 ushtarë.



Shri Lanka sërish vendos gjendjen e jashtëzakonshme



KOLOMBO, 18 KORRIK - Ushtruesi i detyrës i presidentit të Shri Lankës, Ranil Wickremesinghe, në orët e vona të së dielës urdhëroi shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në përpjekje për të parandaluar trazira para votimit të Parlamentit gjatë kësaj jave për zgjedhjen e presidentit të ri.

Udhëheqësit e Shri Lankës kanë vendosur disa herë gjendjen e jashtëzakonshme që prej muajit prill kur nisën protestat kundër qeverisë për shkak të krizës ekonomike dhe mungesës së furnizimeve thelbësore. "Është e përshtatshme pra që të bëhet në interes të sigurisë publike, mbrojtjes së rendit publik dhe mirëmbajtjes së

furnizimeve dhe shërbimeve thelbësore për jetën e komunitetit", u tha në njoftim.

Wickremesinghe njoftoi për gjendjen e jashtëzakonshme javën e kaluar, pasi presidenti Gotabaya Rajapaksa u largua nga shteti për shkak të protestave kundër qeverisë së tij, por gjendja e jashtëzakonshme nuk ishte

shpallur zyrtarisht.

Rregulloret e mëparshme të gjendjes së jashtëzakonshme janë përdorur për ta vendosur ushtrinë në rrugë për t'i arrestuar njerëzit, për t'i kontrolluar pronat private dhe për t'i shtypur protestat. Në kryeqytetin e Shri Lankës, Kolombo, të hënën situata ishte e qetë, pas javësh me protesta masive.

IKD-ja: Gjykatat neglizhuan rastet e politikanëve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 KORRIK - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me përkrahje të Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit dhe NED-it, të hënën ka mbajtur një konferencë për medie, në të cilën është paraqitur raporti "Sfidat në trajtimin e krimeve të përgjithshme", i cili raport derivon nga monitorimi sistematik që IKD ua ka bërë Divizioneve Penale të gjykatave.

Hulumtuesi i IKD-së, Mirvet Thaqi, tha se divizionet penale të gjykatave edhe gjatë vitit 2021 janë ballafaquar me një numër të madh të lëndëve të pazgjidhura, ku në fund të këtij viti të pakryera kanë mbetur edhe 31 314 lëndë penale të përgjithshme. Një fenomen i tillë, sipas Thaqit, është ndër arsyt kryesore se pse lëndët në Divizionet Penale të Gjykatave të Kosovës zvarriten dhe nuk trajtohen brenda afateve ligjore.

Sipas Thaqit, gjetjet e IKD-së tregojnë se gjykatësit e GjTh në Prishtinë janë gati pesëfish më shumë të ngarkuara me lëndë të tilla në krahasim me gjykatësit e GjTh në Mitrovicë. Për këtë arsye, ai tha se Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) duhet të ndërmarrë masa për shpërndarjen proporcionale të

gjykatësve, duke aplikuar edhe transferimin e tyre, në mënyrë që të sigurohet procedimi efikas i lëndëve dhe që gjykatësit të kenë një numër të menaxhueshëm të lëndëve në punë.

Thaqi tha se prokuroria më e ngarkuar me lëndë DP gjatë vitit 2021 ka qenë PTh në Prishtinë me 9 780 lëndë në punë, derisa më së paku lëndë të tilla ka pasur PTh në Ferizaj me 2 120 lëndë DP. Sipas Thaqit, Prokuroria e Prishtinës prin edhe sa i përket ngarkesës mesatare me lëndë DP për një prokuror, ku një prokuror i kësaj prokurorie ka pasur në punë gjithsej 407,5 lëndë DP, derisa më pak të ngarkuara gjatë vitit 2021 ishin prokurorët e PTh në Ferizaj, me një mesatare prej 212 lëndëve në punë për një prokuror.

Monitorimi sistematik i punës së divizioneve penale, sipas Thaqit, ka vënë në pah një trajtim joefikas të aktakuzave të ushtruara ndaj politikanëve. Kjo, sipas tij, manifestohet me faktin se gjykatat gjatë procedimit me lëndë të tilla nuk kanë respektuar afatet ligjore, duke i lënë këto lëndë të pagjykuara për vite me radhë. Ai shtoi se në parim kjo zvarritje, e cila ka qenë karakteristike e rasteve të politikanëve të cilat trajtohen në këto departamente, krijon një perceptim negativ të publiku për mungesë të guximit të gjyqësorit për trajtimin e rasteve të



politikanëve, veçanërisht nëse rastet e të njëjtëve parashkruhen. Sipas tij, zvarritjet në këto raste janë shumë më të mëdha sesa zvarritjet e rasteve të tjera të kësaj natyre. Ndërsa hulumtuesi Gzim Shala ka thënë se, sikurse edhe në vitet e kaluara, Prokurori i Shtetit ka vazhduar të ngrehë aktakuza ndaj të vdekurve. Sipas tij, moszhvillimi i hetimeve ka sjellë në situatat që Prokurori i Shtetit të ushtrojë aktakuza të tilla, të cilat, përveçse të paqëndrueshme në aspektin juridik, e kanë ngarkuar pa nevojë gjyqësorin me lëndë. Ushtrimi i aktakuzave të tilla, sipas Shalës, dëshmon për një mungesë profesionalizmi të prokurorëve që veprojnë në kuadër të sistemit

prokurorial, po ashtu kjo përbën edhe shkelje të detyrave dhe kompetencave të prokurorit të shtetit, të cilët duhet t'i zbatojnë standardet më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare. Ai ka shtuar se këto situata prokurorët mund t'i evitojnë përmes aplikimit adekuat të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve. Mungesë profesionalizmi, sipas Shalës, Prokurori i Shtetit kishte dëshmuar edhe me rastin e ngritjes së aktakuzave ndaj personave të gabuar dhe për çështjet e gjykuara. Në kuadër të këtij raporti analitik Shala tha se është trajtuar edhe procedimi i rastit ndaj ministrit aktual të Punëve të Brendshme,

Xhelal Sveçla, nga gjyqtari i GjTh në Prishtinë, Eroll Gashi. Ai tha se ky gjykatës, për shkak të lëshimeve të raportuara gjatë trajtimit të këtij rasti, tashmë ka humbur kredibilitetin për gjykimin e kësaj lënde. Andaj, ai tha se ky rast duhet t'i ndahet në punë një gjyqtari tjetër, në mënyrë që të mos vihet në dyshim paanësia e tij për trajtimin e këtij rasti.

Sa iu përket të dhënave të siguruar nga analizimi i 100 aktgjyqimeve penale, ku është shqiptuar dënimi i kushtëzuar, Shala tha se gjetjet flasin për aplikim "shabllon" të dënimit me kusht, i cili nuk kombinohet ashtu siç e parasheh ligji, me urdhra të tjerë të veçantë.

Stipe Mesiq shpallet 'Qytetar Nderi i Prizrenit'



PRIZREN, 18 KORRIK (ER) - Ish-presidenti i Kroacisë, Stipe Mesiq, është shpallur qytetar nderi i Prizrenit. "Sot, isha jashtëzakonisht i nderuar që, në një mbledhje solemne të

Kuvendit të Komunës, ta shpallim ish-presidentin e Kroacisë, Stipe Mesiq 'Qytetar Nderi të Prizrenit', në shenjë mirënjohjeje për kontributin dhe veprën e tij për popullin shqiptar.

Me këtë rast, nderuam një personalitet të jashtëzakonshëm dhe i shprehëm edhe një herë mirënjohjen, në emër të popullit tonë, për gjithçka që ai ka bërë për shqiptarët kudo që jetojnë,

ka thënë kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj. Ai ka thënë se kontributi i Mesiqit në forcimin e lidhjeve mes vendeve shqiptare dhe Kroacisë, ka qenë i madh. "Pavarësisht se

në historinë e vendeve tona, kemi qenë kombe e vende mike përherë, por, z. Mesiq e forcoi dhe e ndërtoi lidhjen me rrënjë të forta e të qëndrueshme", ka thënë Totaj.



PARTIA SOCIALISTE E DËRGON NË KUVENDIN E SHQIPËRISË PROJEKTREZOLUTËN KUNDËR RAPORTIT TË DICK MARTYT

Partia e Edi Ramës nis betejën kundër raportit të Dick Martyt

Ashtu siç kishte paralajmëruar kryeministri i Shqipërisë dhe kryetari i Partisë Socialiste (PS), Edi Rama, në qershor të këtij viti, deputetët e partisë që drejton kanë nisur betejën kundër raportit të Dick Martyt. Njëmbëdhjetë deputetë të PS-së kanë dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë projektrezolutën kundër raportit të Martyt, e cila, pasi ta marrë miratimin e deputetëve, do të dorëzohet në Këshillin e Evropës. Sipas kësaj projektrezolute, pretendimet e Martyt kundër liderëve të UÇK-së nuk janë vërtetuar asnjëherë. Në këtë dokument është kërkuar që Këshilli i Evropës të distancohet nga akuzat e Dick Martyt

për Kuvendin e Shqipërisë dhe do të shkojë personalisht në Strasbourg, në rastin më të parë, shpresoj në shtator, për t'iu drejtuar Këshillit të Evropës për një fakt, i cili bëhet gjithnjë e më shqetësues, që është pabazueshmëria totale e raportit të Dick Martyt", kishte deklaruar Rama më 22 qershor të këtij viti. Pas kësaj, PS-ja është kujdesur të evidentojë se 11 vjet pas hartimit të raportit të Dick Martyt, asnjë nga pretendimet e ngritura prej tij në raport nuk janë vërtetuar. Sipas Partisë Socialiste, pas 10 vjet hetime është konstatuar se raporti i Dick Martyt, "për vrasje të personave me qëllim të nxjerrjes dhe shitjes së organeve të tyre dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Shqipëri dhe/apo në Kosovë", mbeten të paargumentuara, të paprovuara dhe të pabazuara në prova dhe fakte, ku për rrjedhojë duhet të konsiderohen si të tilla nga të gjitha institucionet kombëtare e ndërkombëtare. Për këtë PS-ja ka propozuar "Rezolutë mbi pabazueshmërinë e pretendimeve për trafikimin e

paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe Shqipëri". Me këtë rezolutë kërkohet nga Këshilli i Evropës (KE) që të realizojë një raport vijues dhe rishikimin e rezolutës së Dick Martyt, e cila ishte miratuar në vitin 2011. Raporti i vitit 2011 i Dick Martyt, asokohe anëtar dhe raportues i Komitetit për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, ngre pretendime për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore që dyshohen të jenë kryer nga pjesëtarë dhe drejtues të UÇK-së, për të cilat hetuesit ndërkombëtarë nuk kanë gjetur prova. Për shkak të këtij raporti është formuar Gjykata Speciale e cila ka ngrehur aktakuzë kundër drejtuesve kryesorë të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Ata janë duke u mbajtur në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020 edhe pse avokatët disa herë kanë kërkuar lirimin e tyre. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi qysh në daljen e parë para trupit gjykues

janë deklaruar të pafajshëm në lidhje me akuzat e prokurorisë. Përpos tyre, në qendrën e paraburgimit në Hagë janë duke u mbajtur edhe Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Sali Mustafa dhe Pjetër Shala. Kujtojmë se në muajin maj Edi Rama e kishte vizituar Hashim Thaçin në Hagë. Rama kishte thënë se e ka vizituar Thaçin pasi e kishte marrë malli për të.

Përmbajtja e rezolutës mbi pabazueshmërinë e pretendimeve për trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe Shqipëri:

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Shqipërisë, në vijim të qëndrimeve tona të kahershme për vlerësimin e legjitimitetit të luftës heroike e çlirimtare të UÇK-së dhe duke rishprehur qëndrimin tonë se nuk mund të vendosen paralele midis masakrave çnjerëzore, spastrimeve etnike, deportimeve,

EPOKA E RE Lirim GECI

TIRANË, 18 KORRIK - 11 vjet pas hartimit të raportit të ish-senatorit zviceran në Këshillin e Evropës, Dick Martyt, me pretendimet se UÇK-ja ka kryer krime kundër njerëzimit, Partia Socialiste (PS) ka depozituar në Kuvendin e Shqipërisë një rezolutë kundër këtij raporti. Rezoluta do t'i dorëzohet në shtator Këshillit të

Evropës të cilit i kërkohet të distancohet nga akuzat e Martyt të paprovuara nga hetimet ndërkombëtare. Ashtu siç ishte paralajmëruar nga kryeministri shqiptar, Edi Rama, Partia Socialiste, me firmën e 11 deputetëve, ka depozituar në Kuvendin e Shqipërisë një projektrezolutë kundër raportit të Dick Martyt mbi luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). "Ne jemi duke përgatitur një rezolutë

SBASHK-u paralajmëron grevë të përgjithshme para shtatorit

PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) ka njoftuar të hënën se qeveria Kurti nuk është duke i marrë parasysh kërkesat për të dialoguar, derisa ka paralajmëruar "reagime të forta sindikale" para shtatorit, kur është paraparë fillimi i vitit shkollor.

Në një komunikatë për medie, kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, ka thënë se të gjitha institucionet shkollore, adminis-

tratrat në komuna, por edhe të punësuarit e tjerë, do të jenë në grevë të përgjithshme nga shtatori derisa "qeveria Kurti ta ndërrojë qasjen e të kuptojë se duhet të ulët me sindikatat të gjejë zgjidhje". "Kjo qeveri nuk është duke jetuar me realitetin dhe as nuk po e ndien sfidën që të punësuarit në sektorin publik dhe në atë privat po përballen me ngritjen e vazhdueshme të çmimeve të artikujve elementarë dhe se ata ishin të varfër e po bëhen gjithnjë

e më skamnorë. Qeveria Kurti pa shkuar nëpër pushime duhet t'i vë gishtin kokës sepse çmimet kanë shkuar deri në qiell e pagat kanë mbetur në tokë. Qeveria as nuk po ngrit pagat, as nuk po fton në takime sindikatat për të bashkëbiseduar, as nuk po i fton ato për t'u marrë vesh për Ligjin e Pagave. Qeveria po sillet sikur vetëm Kurti e Murati ekzistojnë në këtë nënqiellin e Kosovës", ka thënë Jasharaj.

Më tutje, ai ka thënë se qeverisë i

janë dërguar letra e ndërmjetësues ligjorë për t'u takuar, por që kryeministri Albin Kurti nuk ka pranuar. "I dërguan edhe ndërmjetësuesin ligjor për dialog, që i ngjason atij plakut pleqnar në kohët e Kanunit kur përplaseshin dy fise dhe ata, edhe pse nuk kishin shumë shkollë e nuk kishin lexuar shumë libra sa Albini, pranonin pleqnarët dhe uleshin për të gjetur zgjidhje. Kurtit, Muratit e disa qeveritarëve të tjerë nuk u kanë lënë përshtyp-

je gjithë këto angazhime të sindikatave e as ky pleqnari bashkëkohor e ligjor dhe në këtë mënyrë ata duke mos ndier nevojë as të deklarohen sepse vota e madhe e popullit ua ka trullësuar kokën dhe mendjen, po thonë se nuk japim as pesë para për sindikatat dhe të tjerët", ka thënë Jasharaj.

Sindikata e Arsimit tash e sa muaj kërkon që në Ligjin e Pagave të rritet koeficienti i pagave të mësimdhënësve.



vrasjeve, përdhunimeve, plaçkitjeve dhe krimeve të luftës, nga drejtues dhe anëtarë të makinerisë zyrtare luftarake serbe dhe paramilitarët e saj gjatë luftës në Kosovë, nga njëra anë, dhe integritetit e kauzës së drejtë të luftës së UÇK-së si reagim në mbrojtje të jetës dhe lirisë të popullit në Kosovë, nga ana tjetër. Bazuar në parimin se çdo dyshim për krime duhet zbardhur nga organet e drejtësisë sipas parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe se nuk mund të ketë çështje pafundësisht në hetim por dhe se çdo proces do duhet të mbarojë dikur, me qëllim që popujt të gjejnë forcën të pajtohen e jetojnë së bashku duke shëruar plagët e së shkuarës.


Konstatohet se pas më shumë se dhjetë vitesh hetime të thelluara nga Task Forca hetimore speciale e Bashkimit Evropian (BE) dhe pasardhësit e saj, Zyra e Prokurorit të Specializuar, pretendimet e ngritura në raportin e Dick Marty (Doc. 12462, datë 7 janar 2011), asokohe anëtar dhe raportues i Komitetit për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut në Asamblesë

Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKIE), "për vrasje të personave me qëllim të nxjerrjes dhe shitjes së organeve të tyre dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Shqipëri dhe/apo në Kosovë", të përfshira në rezolutën 1782 (2011) të APKIE-së, pika 1 dhe pika 4, mbeten të paargumentuara, të paprovuara dhe të pabazuara në prova dhe fakte e, për rrjedhojë, duhet të konsiderohen si të tilla nga të gjitha institucionet kombëtare e ndërkombëtare.

Për këtë qëllim propozojmë këtë "Rezolutë mbi pabazueshmërinë e pretendimeve për trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe Shqipëri", ku i kërkojmë Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të realizojë një raport vijues (Follow up Report) dhe si rrjedhojë dhe një rishikim të rezolutës 1782 (2011), duke rivlerësuar pretendimet për trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Shqipëri dhe/apo në Kosovë, në dritën e zhvillimeve që kanë ndodhur gjatë kësaj dekade, fakteve, provave dhe informacioneve të përditësuar,

sikurse dhe sa i përket angazhimit, gatishmërisë dhe bashkëpunimit të plotë të Shqipërisë dhe Kosovës në shërbim të së vërtetës dhe vendosjes së drejtësisë.

Gjithashtu i kërkojmë qeverisë shqiptare të mbetet plotësisht e përkushtuar për të ndihmuar drejtësinë dhe identifikuar përgjegjësinë për të gjitha krimet e kryera në ish-Jugosllavi dhe përsërit thirrjen e tij për të gjithë të interesuarit që të bashkëpunojnë me Mekanizmin Ndërkombëtar për kryerjen e funksioneve të mbetura të gjykatave penale (IRMCT), brenda juridiksionit të saj. Kjo projekt-rezolutë, për të cilën besojmë se do të kemi mbështetjen e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë, rikonfirmon edhe një herë sikurse në rastet e mëparshme, vullnetin e palëkundur për të ndihmuar drejtësinë dhe mbështetur çdo përpjekje që synon të zbulojë të vërtetën. Taulant Balla, Mimi Kodheli, Klotilda Bushka, Etilda Gjonaj, Blendi Klosi, Etjen Xhafaj, Petro Koci, Hatixhe Konomi, Bardhyl Kollçaku, Ilir Pendavini dhe Arben Pëllumbi.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

KUVENDI

PROJEKTREZOLUTË

MBI PABAZUESHMËRINË E PRETENDIMEVE PËR TRAFIKIMIN E PALIGJSHËM TË ORGANEVE NJERËZORE NË KOSOVË DHE SHQIPËRI

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRIË

- Duke iu referuar Rezolutës 1782 (2011) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës ("APKIE") për "Hetimin e pretendimeve për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë", e cila bazohet në një raport (Doc. 12462, datë 7 janar 2011) të Dick Marty, ("Raporti"), asokohe anëtar dhe raportues i Komitetit për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut në APKIE;
- Duke rikujtuar se Raporti u hartua në vijim të një mocioni për rezolutë (Dokumenti 11574, datë 15 Prill 2008), me autor ish anëtarin e APKIE, Konstantin Kosachev, Federata Ruse, Grupi European Demokrat, bazuar në kujtimet e znj. Carla Del Ponte, ish Prokurorë e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Krime Luftë për ish Jugosllavinë ("ICTY"), e cila në librin e saj "Gjuetia: unë dhe kriminelët e luftës", botuar dy muaj pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe rreth tre muaj pasi kishte dhënë dorëheqjen si prokurorë e ICTY, ngrinte dyshime se pjestarë, drejtues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") kishin kryer trajtime çnjerëzore të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe në Shqipëri, krime këto që nuk mund të hetosheshin nga ICTY për mungesë juridiksioni si dhe për shkak të mandatit të kufizuar në kohë dhe territor të kësaj gjykate; Këto pretendime ishin hetuar dhe më parë nga zyra e ICTY, gjatë mandatit të Del Ponte, por nuk ishin gjetur prova për të bazuar pretendimet për kryerjen e këtyre krimeve;
- Duke nënvizuar se Raporti i Dick Marty, në vijim të pretendimeve të ish prokurorës Carla Del Ponte dhe mocionit për rezolutë të nisur prej deputetit rus në APKIE, Kosachev, edhe pse nuk është një raport faktmbledhës apo hetim, ngre pretendime për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore që dyshohen të jenë kryer nga pjestarë dhe drejtues të UÇK ndaj shtetasve serbë, kosovarë dhe komunitetit rom apo minoriteteve të tjera të Kosovës në territorin shqiptar, më konkretisht në veri të Shqipërisë: Kukës, Burrel, Rripe, Cahan dhe Fushë Krujë, në

Spiunët e dyfishtë, dukuri normale të shërbimeve informative dhe kundërinformative!



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

As Fatmir Sheholli nuk bën përjashtim: Çdo shërbim i kundërzbulimit sukseset më të mëdha i ka arritur nëse ka pasur sukses në rekrutimin e spiunëve kundërshtarë në radhët e veta duke i shndërruar në spiunë me dy identitete. Natyrisht se ky rol është jashtëzakonisht i vështirë për ta luajtur, prandaj shumica e tyre, ose janë zënë dhe pushkatuar sikur që ishte rasti i Mata Harit, valltares bukuroshe që u zë dhe u pushkatua, pastaj është rasti i spiunit izraelit, Eli Kohen, që u infiltrua në majat e institucioneve të Sirisë duke u propozuar edhe ministër i Mbrojtjes së Sirisë në kohën e armiqësive të mëdha midis Sirisë dhe Izraelit e që e dëmtoi jashtëzakonisht shumë Sirinë deri në kohën kur u kap në flagrancë nga Shërbimi Kundërzbulues i Sirisë dhe, përkundër përpjekjeve të mëdha të Izraelit që ofroi kushte të jashtëzakonshme për faljen e tij, në praninë e kryetarit të Sirisë me vajzën (ndonëse ishte i martuar në Izrael) të cilin Eli Kohen donte të martohej, si dhe udhëheqësve më të lartë sirianë, gjithashtu në prani të shumë qytetarëve të Damaskut, në sheshin kryesor u ekzekutua me varje në mesvitin e viteve '60. Deri

më tani, përkundër insistimit të Izraelit që të kthehen mbetjet mortore, Siraia nuk ka pranuar t'i kthejë. Edhe agjenti i shquar anglez, Rip Kirbi, për një kohë të gjatë, si agjent i dyfishtë, dërgonte informata në Rusi deri në çastin kur kishte rrezik të zbulohet prandaj, në çastin e fundit, iku në Rusi. Falë informatave që ku i dërgonte në Moskë e që këta ia përcillnin Sigurimit të Shtetit në Shqipëri, shumica e grupeve diverzante që bënin përpjekje të hynin në Shqipëri kapeshin posa zbarkonin në bregdetin shqiptar apo lëshoheshin me parashutë në ndonjë vend malor. Pastaj, Ilaz Basna - Ciceroni që mashtroi të tjerët por, së fundi, u mashtrua duke e paguar me para të falsifikuara e që përfundoi në mjerim. Spiuni më i rëndësishëm që punoi kundër Rusisë, si agjent i dyfishtë ishte Oleg Gordijevski që furnizonte Londrën me materiale sekrete të Rusisë në një periudhë dhjetëvjeçare, deri në vitin 1985 duke i shkruar materialet e ndjeshme me ngjyrë të padukshme në veprat e Shekspirit. Shërbimet e zbulimit dhe kundërzbulimit britanik e kontrabanduan në gepek të automobilit në mënyrë që të shpëtojnë nga arrestimi. Ishte dekonspiruar edhe Projekti Manhattan, prodhimi i bombës atomike nga një amerikan që informonte Bashkimin Sovjetik për ecurinë e prodhimit të bombës atomike. Para mijëra vjetëve shtetet armiqësore siguronin informata përmes agjentëve të dyfishtë duke ua rruar kokën që e përdornin për t'i shkruar informatat e nevojshme pas së cilës prisnin t'i rriteshin flokët

dhe e dërgonin në mision spiunimi. Këto lojëra të spiunimit bëheshin midis ShBA-së dhe Bashkimit Sovjetik, Anglisë dhe Rusisë, Kinës dhe Tajvanit, Izraelit dhe shteteve arabe dhe shteteve të tjera që nuk kishin raporte të mira. Bëheshin edhe midis shteteve mike sikur rasti kur Izraeli spiunoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ka shumë e shumë raste të tjera. Qendrat kryesore të spiunimit dhe rekrutimit janë ambasadat dhe përfaqësitë diplomatike, konzulare, tregtare, kulturore etj. ku edhe bëhet rekrutimi.

Kohën e fundit doli një informatë se Fatmir Sheholli paska qenë spiun i LDK-së para luftës së fundit dhe spiun i ShIK-ut, pas përfundimit të luftës, duke deklaruar se shef e ka pasur Kadri Veselin sikur edhe Latif Gashin dhe Ilmi Reçicën, me të cilët, siç thotë Fatmiri, kanë bërë punë të mira për Kosovën. Kush është nga Llapi dhe kush e njejtë Fatmir Sheholli e ka të qartë këtë të vërtetë ndryshe, nuk do të kishte teori që Fatmir Sheholli të mbijetojë në Kosovë pas përfundimit të luftës. Jam i sigurt se Fatmir Sheholli, materialet që i ka konsideruar të ndjeshme dhe të klasifikuara, i ka dërguar edhe në ambasadat kryesore të shteteve të huaja në Kosovë. Është një rregull që thotë se "një herë spiun, gjithmonë spiun dhe se, nëse keni vazhduar apo bërë përpjekje ta mashtroni shërbimin amë që ju ka rekrutuar, pa asnjë dyshim keni përfunduar në arkivol, nëse nuk jeni larguar me kohë apo nuk keni ndryshuar identitetin...". Keni dëgjuar disa deklarata publike të Fatmir Sheholliit ku e

sulmon UÇK-në, në veçanti Hashim Thaçin, pas së cilave vazhdoi të jetojë, pa asnjë problem në Kosovë! Krejtësisht normale për një agjent të dyfishtë apo të shumëfishtë, për të marrë diçka, duhet të japësh diçka! Unë nuk shoh asgjë të keqe që Fatmir Sheholli qenka rekrutuar nga ShIK-u, nëse ishte rekrutuar, por vetëm kam një dilemë nëse ShIK-u ka pasur kapacitete të mjaftueshme dhe profesionalizëm t'i marrë informatat e duhura dhe ta mësojë Fatmir Sheholli se si të sillet me shërbimet e zbulimit dhe kundërzbulimit të Serbisë! Fatmir Sheholli ka punuar në fushën e analizës së sistemit informativ të Serbisë që nënkupton se nuk ka qenë spiun i thjeshtë, por se ka pasur njohuri të bollshme profesionale. Pas daljes nga burgu në vitin 1990, tërë kohën kam qenë i përcjell nga shërbimi sekret i Serbisë dhe i Kosova Metohisë, pjesë e së cilës ishte Fatmir Sheholli. Pas përfundimit të luftës këtë ma ka vërtetuar edhe vetë Fatmir Sheholli. Më kujtohet një rast kur Rade Novičević, shef i UDB-së për Llap, pas daljes nga burgu, pasi e kishte rrahur keq patriotin e madh, Xheladin Rekalium, më pyeti nëse në shtëpinë time, në qendër të Podujevës, e që ishte përballë dhe në vëzhgim 24-orësh nga sigurimi serb, kanë qenë ndonjëherë Baca Adem Demaçi dhe Ahmet Haxhiu. Iu përgjigja, si nga rufeja, se jo që kanë qenë një herë, por kanë qenë me dhjetëra dhe qindra herë dhe se shtëpia ime ishte edhe shtëpia e tyre. Për këtë nuk më pyeti më asgjë! Ku është fati që dikur ShIK-u të kishte kapacitet të rekrutojë

agjentë të dyfishtë sikur që AKI-ja të mund të rekrutojë agjentë të tillë?! Kjo drejtpërdrejt ndikon në sigurinë e qytetarëve dhe të vendit. Në fund të fundit, çdo shërbim i zbulimit dhe kundërzbulimit e ka këtë qëllim. Por, në një mjedis ku edhe pordha politizohet, ngrihen dilema të tilla e që e shpërfaq tërë mediokritetin dhe injorancën tonë në këtë fushë, jashtëzakonisht të ndjeshme dhe të rëndësishme për shtetin. Prandaj, asnjëherë nuk e kam injoruar Fatmir Sheholliin dhe është fat i madh nëse ai ka dhënë informata të duhura, nëse ka pasur qasje te këto informata të klasifikuara nga Serbia. Po sot, në institucionet e Kosovës, edhe ato më të larta keni individë që kanë bërë shumë më shumë dëme se që ka bërë Fatmir Sheholli, nga hetues policorë që kanë mbytur nën torturë shumë patriotë shqiptarë, prokurorë dhe gjykatës, pronarë të medieve dhe gazetarë, historianë, sportistë dhe artistë dhe shumë profile tjera. Për fund, njëri ndër hetuesit kryesorë në procesin e montuar politik kundër ushtarëve shqiptarë në Iliriska Bistricë e që janë dënua para Gjykatës Ushtarake në Zagreb, ishte shqiptar dhe, pas përfundimit të luftës, ka qenë bartës i një posti të lartë institucional, i mbrojtur nga UNMIK-u, sigurimi serb dhe nga disa politikanë shqiptarë. Në atë proces të montuar politik, pa bërë asgjë, ishin dënua: Hysen Shurdhani, 12 vjet, Zenel Baçaj, 9 vjet, Shefki Barileva 7 vjet, Brahim Mazreku, 6 vjet, Behxhet Sh. Shala, 12 vjet, Isa Jashari dhe Hysen Zymberi nga 5 vjet, Fatmir Ahmeti, 4 vjet dhe Rrahim Rama, 1 vjet.

Gazetare të tjera ukrainase strehohen në Kosovë

PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Në Kosovë kanë mbërritur edhe dy gazetare ukrainase, Iryna Synelnyk dhe Oksana Chykanch. Gazetarët janë mirëpritur nga kolegja e tyre Lyudmila Makey, kryetari i Bordit të AGK-së, Xhemajl Rexha, zyrtarja ligjore e ECPMF-së, Flutura Kusari, si dhe përfaqësues të MPB-së dhe Policisë së Kosovës.

Synelnyk dhe Chykanch do të strehohen në Kosovë në kuadër të programit "Journalists in Residence - Kosovo", i cili është iniciuar nga European Centre for Press and Media Freedom ECPMF dhe European Federation of Journalists - EFJ, e që mbështetet financiarisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Programi është duke u

zbatuar nga Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me ECPMF-në, ku deri më tani kanë strehuar gjashtë gazetarë. "Journalists in Residence - Kosovo" ofron pagë mujore, akomodim në banesë, kushte për punë, kurse të gjuhës dhe të integritetit, si dhe ndihmë psiko-sociale sipas nevojës.



Bislimi: Pozita e Kosovës në procesin e dialogut s'ka qenë kurrë më mirë

PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi ka thënë se pozita e Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë s'ka qenë kurrë më

mirë. Duke raportuar në Komisionin për Integrime Evropiane, Zhvillim e Dialog, ai ka thënë se s'ka asnjë arsye për brenga dhe skepticizëm. "Unë si

kryenegociator kam mandat të qartë dhe atij mandati i përmbahem 100 për qind. Në atë mandat s'ka asnjë lëkundje. Pozita e Kosovës në procesin e

dialogu s'ka qenë kurrë më mirë dhe s'ka asnjë arsye për brenga apo skepticizëm në tërësi. Munde të flini sh lirë", ka thënë Bislimi.



Kosova regjistron dy viktime dhe mbi 600 raste të reja me Covid-19

Prishtinë, 18 korrik (ER) - Dy persona kanë vdekur dhe janë regjistruar 615 raste të reja me koronavirus, bëri me dije të hënën Ministria e Shëndetësisë e Kosovës (MSh).

Sipas raportit ditë, MSh-ja njofton se rastet e reja dolën pas testimit të 1 465 mostrave. Nga kjo shifër i bie që përqindja e rasteve që kanë dalë pozitivë me sëmundjen Covid-19 është 41.97 për qind.

Në 24 orët paraprake janë shëruar edhe 285 persona. Aktualisht, raste aktive me koronavirus në Kosovë janë 5 687.

Kosova së fundmi po regjistron rritje të rasteve me sëmundjen Covid-19, duke shtyrë autoritetet që të bëjnë thirrje që qytetarët të mbajnë maska në ambiente të

mbyllura dhe të vaksinohen kundër koronavirusit.

Sipas raportit të datës 18 korrik, të klinikave Covid-19 në QKUK, por dhe të spitaleve të përgjithshme, në trajtim mjekësor janë 61 pacientë të konfirmuar me Covid-19. "30 pacientë janë të shtrirë në klinikat e QKUK-së dhe 31 në spitalet e përgjithshme. Raporti sipas klinikave dhe spitaleve të përgjithshme:

Klinika Infektive, 20 pacientë; Mjekim Intensiv Qendror, 1 pacient; Klinika e Pediatriisë, 5 pacientë; Klinika e Gjinekologjisë, 3 pacientë; Klinika e Neonatologjisë, 1 foshnjë; Spitali i Gjakovës, 8 pacientë; Spitali i Pejës, 13 pacientë; Spitali i Gjilanit, 7 pacientë dhe Spitali i Mitrovicës, 3 pacientë", ka njoftuar ShSKUK-ja.



Sveçla: Kosova nuk ka luftëtarë në Ukrainë



PRISHTINË, 18 KORRIK - Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, ka mohuar çdo mundësi që ndonjë qytetar i Kosovës të jetë bërë pjesë e luftës në Ukrainë ashtu siç pretendon Moskë zyrtare.

Ministri Sveçla tha për "Radio Evropa e Lirë" se institucionet e Kosovës nuk kanë asnjë informacion që ndonjë qytetar i Kosovës të jetë duke luftuar si mercenarë në luftën në mes të Ukrainës dhe Rusisë që filloi më 24 shkurt të këtij viti. Që nga kjo datë Rusia ka publikuar në disa raste të dhëna për numrin e mercenarëve që, sipas, saj janë rreshtuar krahe forcave

ukrainase.

Më 17 qershor Ministria e Mbrojtjes e Rusisë publikoi një listë në të cilën pretendon se që nga 24 shkurti, 156 qytetarë nga Kosova u janë bashkuar luftimeve në Ukrainë. "Ne nuk kemi asnjë informacion se asnjë qytetar i Republikës së Kosovës është pjesë e luftës në Ukrainë e për më pak se edhe paskemi viktime nën ta, ashtu siç paskan pas deklaruar agjencitë e [Vladimir] Putinit", tha ministri Sveçla.

Ministria e Mbrojtjes e Rusisë me tej pretendon se ka eliminuar 61 luftëtarë nga Kosova nga data 24 shkurt e deri më 17 qershor 2022.

Krasniqi nënshkruan në librin e zisë me rastin e vrasjes së ish-kryeministrit të Japonisë

PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka nënshkruar në librin e zisë, në Ambasadën e Japonisë në Prishtinë, me rastin e vrasjes së ish-kryeministrit, Shinzo Abe, ditë më parë.

Krasniqi ka thënë se ish-

kryeministri Abe ishte mik i mirë i Kosovës, mbështetës i madh në shtetndërtimin tonë dhe lider i urtë e frymëzues. "Gjithmonë jemi mirënjohës për kontributin e veçantë dhe të vazhdueshëm, personal e shtetëror që ish-kryeministri Abe ka treguar për vite me radhë ndaj vendit tonë. Pas

nënshkrimit në librin e zisë, takova të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Japonisë në Kosovë, z. Keisuke Yamanaka, me të cilin diskutuam edhe për thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve tona në fusha të ndryshme", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".



PDK-ja: Subvencionimi i përkohshëm i punësimit, eksperiment i panevojshëm i qeverisë



PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Koordinator i Departamentit për Financa në Kabinetin për Qeverisje të Mirë të Partisë Demokratike të Kosovës, Arben Mustafa, në një konferencë për medie e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për eksperimentim me paranë publike në mungesë të aftësisë për ta menaxhuar krizën ekonomike në Kosovë. Mustafa ka theksuar se nisma e fundit e Qeverisë së Kosovës për subvencionimin e përkohshëm të punësimit nuk ka efekt substancial për

ta zgjidhur problemin e papunësisë. "Papunësia është problem strukturor i ekonomisë së Kosovës dhe nuk mund të adresohet me masa gjashtëmujore dhe të njëhershme, sidomos kur ato janë të dizajnuara vetëm sa për të theksuar fraza populiste sikur ajo 'çdo shtëpi nga një të punësuar', të bazuara në kritere vështirë të plotësueshme dhe që vetëm sa stimulojnë mashtrimin me paranë publike. Për më tepër, hartimi i masave të tilla pa një vlerësim paraprak të numrit të

përfituesve të mundshëm dhe kostos së pritur për buxhetin e shtetit paraqet një menaxhim të papërgjegjshëm të financave publike", ka thënë ai. Mustafa ka thënë se kërkesa e pamjaftueshme për punëtorë, e cila vjen nga kapacitetet e ulëta të prodhimit vendor, si dhe mospërputhja ndërmjet aftësive të kërkuara dhe atyre të ofruara në tregun e punës, janë shkaqet kryesore të papunësisë në Kosovë. "Për ta adresuar problemin e parë, atë të kërkesës së

pamjaftueshme në ekonominë e Kosovës, si nevojë më urgjente është që qeveria t'u kthehet investimeve publike kapitale, të cilat asnjëherë nuk kanë qenë më të ulëta se aktualisht. Shkalla e realizimit të projekteve kapitale në raport me planin vjetor në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 sillet në vetëm rreth 10 për qind të planit vjetor. Investimet kapitale të qeverisë janë të domosdoshme për ta rritur kërkesën e përgjithshme në planin

afatshkurtër dhe për t'i krijuar kushtet për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në planin afatgjatë. Po ashtu, Qeveria e Kosovës duhet t'i përdorë instrumentet e saj fiskale për ta frenuar rritjen e çmimeve dhe të ndërmarrë masa që tanimë kemi propozuar për t'i ndihmuar qytetarët me të ardhura fikse që ta përballojnë rritjen e çmimeve", ka deklaruar ai. Ndërkaq sa i përket mospërputhjes mes aftësive të kërkuara dhe atyre të ofruara në tregun e punës, Mustafa propozoi që qeveria duhet të ofrojë programe të aftësimi profesional për të papunët ekzistues në mënyrë që ata t'i përfitojnë aftësitë e kërkuara nga tregu i punës. "Ndërsa, në një plan më afatgjatë, qeveria duhet t'i përshtatë programet e arsimit të mesëm dhe të lartë në atë mënyrë që sistemi arsimor i vendit të prodhojë një fuqi punëtoreshme më të aftë për t'iu përshtatur nevojave të tregut. Qeveria e Kosovës duhet ta kuptojë se vendi gjendet në krizë ekonomike dhe nuk ka kohë të humbë me eksperimente të tilla që shpërdorojnë paranë publike. Qytetarët e Kosovës kanë nevojë për të ardhura të qëndrueshme nga punësimi dhe jo për lëmosha të kohëpaskohshme", ka thënë koordinatori i Departamentit për Financa në KQM, Arben Mustafa.

Skema e re e qeverisë: Çdo familje një anëtar të punësuar

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 KORRIK - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka hapur të hënën aplikimin për skemën 'Qeveria për familjet' që synon punësimin afatgjatë për punëkërkuarët që nuk kanë asnjë anëtar të familjes të punësuar. Kushtet për aplikim nga punëkërkuarët: T'i përkasin grupmoshës 18-64 vjeçare; Të mos kenë asnjë anëtar të familjes të punësuar; dhe të jenë të regjistruar si të papunë/punëkërkuar në Agjencinë e Punësimit (APRK). Kushtet për aplikim nga punëdhënësit: Bizneset të jenë të regjistruara dhe aktive në Administratën Tatimore të Kosovës; OJQ-të të jenë të regjistruara dhe aktive në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Mënyra e subvencionimit: Kompensimi për punëdhënësin:

70% e pagës bruto (maksimumi 300 euro subvencionim nga qeveria për punëtor); Personat e angazhuar përmes kësaj skeme nuk duhet të përbëjnë më shumë se 30% të stafit ekzistues të biznesit. Ministri i Financave i Kosovës, Hekuran Murati, ka thënë se secili mbajtës i familjes në cilën nuk është i punësuar asnjë anëtar do t'i mundësohet punësimi në ndonjë nga kompanitë e sektorit privat apo edhe organizata joqeveritare. "Bizneset që janë të interesuara të punësojnë mbajtës të familjes do t'i mbështesim deri në 70 për qind të pagës bruto, ne do t'i publikojmë kriteret dhe ata persona që nuk kanë të punësuar duhet të lajmërohen në Agjencinë për Punësim dhe të tregojnë për cilat fusha kanë aftësi", ka thënë Murati. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave, papunësia në Kosovë është mbi 25 për qind.



Të dhënat e fundit të ASK-së për tregun e punës tregojnë se nga mbi një milion qytetarë në moshë pune në Kosovë, mbi 350

mijë janë të punësuar, ndërsa mbi 120 mijë janë të papunë. Sipas ASK-së, rreth 750 mijë qytetarë janë ekonomikisht

joaktivë, që do të thotë se nuk janë të punësuar, as të regjistruar si të papunë dhe as nuk kërkojnë punë.

Pesë mënyrat për t'u përballur me taktikat e shantazhit ushqimor të Vladimir Putinit



Nga Mark LYNAS

Ndërsa lufta në Ukrainë po vazhdon, presidenti rus Vladimir Putin ka nisur zbatimin e një taktikë të re, duke u përpjekur ta shantazhojë botën përmes privimit nga ushqimet. Duke bllokuar portet e Ukrainës në Detin e Zi, dhe duke ndaluar eksportin e të korrave të jashtëzakonshme të grurit në tregjet botërore, Putini po përdor kërcënimin e urisë ndaj vendeve në zhvillim të varura nga importi, si një taktikë për të kërkuar lehtësimin e sanksioneve.

Mënyra e vetme për ta përballuar këtë shantazh, pa e zhytur në një zi buke jugun e botës – në mungesë të masave të suksesshme për të hequr bllokadën – është kursimi i burimeve ushqimore gjetkë. Në një raport të ri për grupin mjedisor pro-shkencës “RePlanet”, unë listoj 5 mënyrat kryesore për t’iu kundërvënë këtij shantazhi.

1. Hiqni bllokadën ruse

Gjëja e parë dhe më e rëndësishme është të kërkohet nga Putini të heqë bllokadën, në

mënyrë që të eksportohet gruri i Ukrainës. Siç është shprehur drejtori i Programit Botëror të Ushqimit, Dejvid Bizli: “Për momentin, kaponet e grurit në Ukrainë janë plot. Ndërkaq, 44 milionë njerëz në mbarë botën janë në prag të urisë. Ne duhet t’i çlirojmë këto porte, në mënyrë që ushqimi të mund të lëvizë brenda dhe jashtë Ukrainës.” Përdorimi i urisë si një taktikë ushtarake, është një krim lufte. E gjithë bota duhet ta dënojë atë, dhe të mobilizohet për të këmbëngulur që Putini të lejojë hapjen e porteve ukrainase”.

2. Stop përdorimit të drithit për funksione të tjera përveç ushqimit

Sipas të dhënave më të fundit, Evropa djeg ekuivalentin e 15 milionë bukëve çdo ditë nëpërmjet përdorimit të grurit si lëndë e parë për biokarburantet e lëngëta. Në fillim këto lëndë djegëse supozohej të ishin “të rinovueshme”, dhe me emetime të pakta të karbonit në atmosferë.

Por tani të dhënat sugjerojnë se ndikimi i tyre mbi klimën, mund të jetë edhe më i keq se ai i

karburanteve fosile. Ne në “RePlanet” llogarisim se rreth një e pesta (20 për qind) e eksporteve totale të grurit të Ukrainës, mund të zëvendësohet nëse i jepet fund përdorimit të grurit evropian për prodhimin e etanolit për makinat dhe kamionët.

Ky është ushqimi që mund të ushqejë jugun e botës. Megjithatë, ai po vazhdon të digjet nga evropianët e pasur në makinat e tyre. Kjo mund dhe duhet të ndalet menjëherë, siç përkërkohet tani edhe liderët e Britanisë së Madhe dhe Gjermanisë.

3. Hani më pak mish

Më pak 1/3 treta e drithërave në Evropës konsumohen drejtpërdrejt nga njerëzit. Shumica shkon për ushqimin e kafshëve. Me proteinat alternative dhe fermentimin e saktë, bota po ilargohet edhe këtij përdorimi joefikas të burimeve. Kalimi tek dietat me bazë bimore, mund të përmirësojë shëndetin tonë, dhe të kursejë sasi të mëdha toke dhe ushqimesh.

Nëse evropianët do të përgjysmojmë konsumin e mishit, ne llogarisim se do të

kurseheshin 80 milionë tonë drithëra, shumë më tepër se 55 milionë tonë eksporte të drithërave të Ukrainës para luftës.

4. Heqja e ndalimeve për aplikimin e gjenetikës në mbarështimin e të korrave

Ndalimet jo-shkencore të Evropës ndaj transgjenikës dhe teknologjive të modifikimit të gjeneve tek të korrat, kanë sjellë një humbje të madhe të produktivitetit. Kjo do të thotë se më shumë ushqime të përdorura në Evropë duhet të importohen nga gjetkë, duke rritur çmimet e mallrave, dhe duke lënë pa ushqim njerëzit më të varfër të botës.

Një studim ka treguar se përfitimet mesatare të rendimentit nga gjenerata e parë të kulturave të modifikuara gjenetike ishin 22 për qind, me përfitimet më të mëdha në vendet në zhvillim. Nëse një rritje e prodhimit prej vetëm 20 për qind do të zbatohet në prodhimin e drithit në Evropë, kjo do të rriste të korrat me 55 milionë tonë, shifër e barabartë me eksportet e Ukrainës para luftës.

5. Të anulohet kalimi tek bujqësia organike

Strategjia e re e BE-së “Farm to Fork”, kërkon që 25 për qind e tokës bujqësore të Evropës, t’i nënshtrohet bujqësisë organike deri në vitin 2030 (shkalla aktuale është 7.5 për qind). Kjo mund të jetë vërtet më e mirë për kafshët në ferma, për shkak të reduktimit të plehrave sintetike dhe pesticideve.

Por pa plehra kimike, dhe pa masa të besueshme për të reduktuar infektimet nga dëmtuesit, fermat e bujqësisë organike do të pësojnë humbje të mëdha në produktivitet, mesatarisht rreth 40 për qind krahasuar me fermat tradicionale që njohim sot.

Për shkak se ushqimi duhet të vijë nga diku, kjo do të thotë se më shumë bujqësi organike do të rritë importet, duke vënë nën një presion çmimit, duke çuar në gjetjen e tokave të reja dhe humbjen e biodiversitetit diku tjetër. Për të gjitha drithërat të kombinuara, ne llogarisim se një zhvendosje në nivelin 25 për qind të prodhimit organik do të reduktonte me 20 milionë tonë prodhimin e drithërave në Evropë. / “Alliance for Science” – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Medalistët e Lojërave Mesdhetare priten nga kryeministri Albin Kurti



PRISHTINË, 18 KORRIK - Medalistët e Lojërave Mesdhetare "Oran 2022", në krye me presidentin e Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, janë pritur të hënën nga kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, i cili shoqërohej nga ministri për Kulturë, Rini dhe Sport, Hajrullah Çeku dhe zëvendësministria e MKRS-së, Daulina Osmani. Të pranishëm në takim ishin edhe drejtuesit e Federatave të Xhudos së Kosovës (FXHK) dhe Federatës së Boksit të Kosovës (FBOXK), Agron Kuka dhe Enver Krasniqi, trajneri i xhudos Driton Kuka dhe trajneri i boksit Besim Brahimi, kampionia olimpike "Rio 2016", Majlinda

Kelmendi si dhe sekretari i përgjithshëm i FBOXK-së, Latif Demolli. Ekipi i Kosovës fitoi gjashtë medalje në "Oran 2022", pesë nga xhudoja dhe një nga boksi. Të artat i fituan xhudistet Distria Krasniqi, Loriana Kuka e Laura Fazliu, ndërsa të bronzat xhudistet Akil Gjakova e Flaka Loxha dhe boksieri Shpejtim Bajoku. Kryeministri Kurti përgëzoi ekipin për suksesin e arritur, duke thënë se sportistët vazhdojnë ta bëjnë krenar vendin tonë me paraqitjet në garat ndërkombëtare, ndërsa vlerësoi lart rritjen e numrit të medaljeve nga katër vjet më parë, kur numri i medaljeve të fituara në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018" ishte katër,

të gjitha nga xhudo. Presidenti Ismet Krasniqi theksoi se, përkundër që Algjeria nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, mikpritja e tyre ishte tejet e ngrohtë, ndërsa simbolet tona shtetërore ishin kudo, duke mos hasur as në më të voglin problem. Më tutje, i pari i KOK-ut shtoi se numri i rritur i medaljeve nga "Tarragona 2018" jep shpresë se edhe në Lojërat Olimpike Paris 2024 numri i medalistëve do të rritet nga "Tokio 2020". Për paraqitjen e ekipit të Kosovës dhe suksesin e arritur folën edhe ministri Çeku, kryetarët e federatave, trajnerët, por edhe sportistët, të cilët janë optimistë për suksese të reja në arenën ndërkombëtare.

Gjilani mbetet pa president, Zuka jep dorëheqje

GJILAN, 18 KORRIK - Florim Zuka ka dhënë dorëheqje nga pozita e presidentit të klubit të Gjilanit. Këtë lajm e ka konfirmuar vetë Zuka të hënën në llogarinë e vet në "Facebook". Arsyeja për këtë, sipas tij, është fakti se nuk ka arritur qëllimin final, titullin e kampionit. Bashkë me të është dorëhequr edhe kryesia e klubit. "Në fillim të vitit 2017 e morëm në menaxhim Klubin e Futbollit SC Gjilani. Që nga momenti i parë jam angazhuar që klubi të ketë një strukturë të qëndrueshme administrative dhe jam kujdesur maksimalisht që në aspektin financiar të mos ketë asnjë problem. Për këto pesë vjet e gjysmë kemi investuar një shumë të madhe të mjeteve financiare, e tëra pasuri familjare, duke sjellë në klub lojtarë për të cilët kemi menduar se mund t'i arrijmë synimet e përbashkëta që SC Gjilani të pozicionohet në mesin e klubeve më të suksesshme në Kosovë. Megjithatë kemi krijuar një organizim dhe stabilitet të kënaqshëm, ku për këtë



periudhë kohore dy herë kemi siguruar pjesëmarrjen në garat evropiane, prapëseprapë duhet ta pranojmë se nuk e kemi arritur qëllimin final, që ka qenë titulli kampion. Përkundër rezultateve të arritura, konsiderojmë se kjo nuk ka qenë e mjaftueshme dhe për këtë arsye që nga momenti i publikimit të këtij njoftimi ofroj dorëheqje të përvokueshme nga pozita e kryetarit të Klubit SC Gjilani. Njëkohësisht edhe kryesia aktuale ka dhënë dorëheqje së bashku me mua",

ka thënë Zuka. Ky i fundit më pas ka kërkuar nga sportdashësit, donatorët dhe përfaqësuesit e institucioneve komunale të japin kontribut për themelimin e një kryesie të re. "Ftojme të gjithë sportdashësit, donatorët, përfaqësuesit e institucioneve komunale dhe çdo person tjetër të interesuar, që të japë kontributin e vet për krijimin e një kryesie të re në mënyrë që SC Gjilani të vazhdojë tutje drejt synimit të përbashkët, titullit kampion", ka shtuar Zuka.

Garë e jashtëzakonshme në Prishtinë, triumfon Antwerp



Prishtinë, 18 korrik - Ka përfunduar gara e FIBA 3x3 Prishtina Challenger, që u zhvillua gjatë fundjavës në kryeqytetin e Kosovës. Dy ditë me spektakël të streetbollit dhe muzikës, Prishtina ishte në qendër të vëmendjes me një turne madhor dhe madhështor. Kjo garë u organizua nga 3x3 Prishtina me mbështetje të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), komunës së Prishtinës dhe Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK). 14 skuadra morën pjesë, fillimisht në grupe, më pas në çerekfinale, gjysmëfinale dhe finalja, që ishte shumë dramatike mes Antwerpit të Belgjikës dhe Friburgut të Zvicrës, ku belgët

triumfuan pas vazhdimëve 18:17. Antwerpi, Friburgu dhe Amsterdami u kualifikuan për Masters në Debrecen më 27-28 gusht 2022.

Renditja

Antwerp (BEL)
Friburg (ZVI)
Amsterdam (HOL)
Vienna (AUT)
Düsseldorf/LFDY (GJER)

Top shënuesit

Thibaut Vervoort (Antwerp, BEL) 46 pikë
Jonathan Dubas (Fribourg, ZVI) 40
Jonathan Kazadi (Fribourg, ZVI) 31
Nick Celis (Antwerp, BEL) 27
Matthias Linortner (Vienna, AUT) 27

Të enjten tërhiqet shorti për Superligë dhe Ligën e Parë

PRISHTINË, 18 KORRIK - Komisioni i Garave ka njoftuar klubet e Superligës

dhe Ligës së Parë se tërheqja e shortit për edicionin e ri garues

2022/23 do të bëhet të enjten, më 21 korrik, në selinë e FFK-së. Tërheqja e

shortit për Superligë do të bëhet nga ora 13:00, kurse për Ligën e Parë, Grupi A,

do të bëhet nga ora 13:30, ndërsa nga ora 14:00 tërhiqet shorti për grupin B.

Gërbeshi rikthehet tek Ulpiana

LIPJAN, 18 KORRIK - Mbrojtësi Fidan Gërbeshi edhe zyrtarisht është rikthyer te skuadra e Ulpianës. Klubi lipjanas e ka konfirmuar transferimin e Gërbeshit përmes një postimi në

"Facebook". Gërbeshi në edicionin e kaluar mbrojti ngjyrat e Malishevës, ndërsa më parë ka luajtur te Drita, Feronikeli dhe Arbëria. "Fidan Gërbeshi rikthehet në shtëpi, për t'i dhënë sigurinë e duhur

ekipit bardh e kaltër. Në ambientet e klubit presidenti i KF Ulpiana, Jeton Gashi, ka arritur marrëveshje me qendërmbrojtësin lipjanas Fidan Gërbeshi për stinorin 2022/2023. Gërbeshi për

shumë vjet ka luajtur në Superligën e Kosovës, për: Ulpianën, Feronikelin, Dritën, Arbërinë dhe në sezonin e fundit ka luajtur te Malisheva", thuhet në njoftimin e skuadrës së Ulpianës.



Kurti: Kënaqësi e veçantë kur kupën botërore e fiton në shtëpinë tënde

PRISHTINË, 18 KORRIK - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, e ndoqi finalen e meshkujve të Kupës Botërore të Hendbollit Universitar, në të cilën djelmoshat e Kosovës u shpallën kampionë. Ndeshja finale u luajt ndërmjet Kosovës dhe Koresë së Jugut. Kurti ka shkruar në profilin e vet në "Facebook" se fituam 33:30. "Kënaqësi e veçantë atëherë kur kupën botërore e fiton në shtëpinë tënde. Shumë urime të gjithë sportistëve dhe studentëve të Kosovës! Pas palestresë 1 Tetori në Prishtinë, u ktheva në sheshin 'Zahir Pajaziti' në atmosferën fantastike të cilën e ka sjellë në kryeqytet aktiviteti ndërkombëtar 3x3 Challenger Prishtina. Në një ndeshje tejet të barabartë, në vazhdimë ekipi i Antwerpit të Belgjikës e mundi 18:17 atë të Friburgut të Zvicrës. Të dyja këto



aktivitete janë mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Turizmi sportiv është politikë e veçantë e Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes së cilës po e vendosim Kosovën në

hartën e shteteve që organizojnë ngjarje ndërkombëtare, gjersa ua ofrojmë të rinjve tanë mundësinë që t'i ndjekin këto aktivitete nga afër", ka shkruar Kurti.

Hamiltoni: Russell është e ardhmja e Mercedesit, ka potencialin për t'u shpallur kampion

LONDËR, 18 KORRIK - Sezoni 2022 në Formula 1 për skuadrën e Mercedesit nisi më mirë për George Russellin, që ishte konstant dhe renditej gjithnjë në "top-5". Në garat e fundit duket se është Lewis Hamiltoni ai që po paraqitet më mirë në pistë. Hamiltoni ka folur mirë për shokun e tij të skuadrës, duke u shprehur se janë ndierë mirë duke punuar së bashku. "George pati një impakt shumë pozitiv te skuadra dhe puna që kemi kryer të gjithë së bashku", u shpreh Hamiltoni, shtatë herë kampion bote në Formula 1. "Ishte argëtuese të qëndronim bashkë dhe kemi punuar jashtëzakonisht shumë. Ka bërë një punë të mirë dhe ka arritur rezultate të mira. Mendoj se në të ardhmen ka potencialin për t'u shpallur kampion me Mercedesin", ka deklaruar



Hamiltoni. "Mendoj se e ardhmja e Mercedesit është në duar të sigurta, pasi është pilot i jashtëzakonshëm, që mund të përmirësohet edhe më shumë.

Ardhja e tij këtu ishte zgjedhja e duhur dhe shpresoj ta ndihmoj sa më shumë për t'u rritur profesionalisht", ka shtuar Hamiltoni.

SHKURT

Lewandowski: Gjithmonë kam dashur të luaj në La Liga

Sulmuesi Robert Lewandowski ka thënë se vendimi për t'iu bashkuar Barcelonës ishte ajo çka ka dashur gjithmonë. Sulmuesi polak bëri me dije se ka dashur të luajë në La Liga dhe për një ekip të madh. "Kjo ishte një mundësi për mua personalisht. Gjithmonë kam dashur të luaj në La Liga dhe për një ekip të madh. Jam shumë i lumtur që jam këtu. Ishte shumë e lehtë të vendos për të ardhur te Barça", ka thënë Lewandowski, i cili shpreson ta nisë me fitore aventurën te klubi katalunas. "Barça është kthyer. Mendoj se mund ta ndihmoj skuadrën për ta kthyer në krye të futbollit evropian. Shpresoj të fillojmë me fitore. Më pëlqen të fitoj trofe dhe ky është një kapitull i ri për mua, me sfida të reja. Unë kam folur tashmë me Xavin dhe i di idetë e tij. Ai ishte një lojtar i madh dhe ka një të ardhme të madhe përpara si trajner", ka deklaruar Lewandowski.

Roma fiton garën për Dybalan

Sulmuesi argjentinas Paulo Dybala e ka pranuar ofertën e Romës dhe po përgatitet të vihet në dispozicion të Jose Mourinhos për sezonin e ardhshëm. Goditje e madhe nga klubi kryeqytetas, i cili siguron një lojtar të nivelit më të lartë falas. Kërkesat financiare të futbollistit janë plotësuar në bazë të një kontrate trevjeçare, që përfshin një pjesë fikse dhe bonuse. Të dyja bashkë arrijnë në 6 milionë euro në sezon. Jose Mourinho kësaj mposhti konkurrencën e Napolit dhe Interit në garë për sulmuesin që ishte pjesë e Juventusit.

Broja, afër marrëveshjes me West Hamin

Sulmuesi i kombëtares shqiptare, Armando Broja, pak ditë pasi u bashkua me Chelsea në fazën përgatitore në ShBA, rikthehet në Angli për ta mbyllur marrëveshjen me West Hamin. Sipas asaj që raporton gazetari sportiv Fabricio Romano dhe Adam Njuzon, thuhet se 20-vjeçari ka udhëtuar për në ishull dhe se klubi i West Hamit është shumë pranë marrëveshjes me shqiptarin, i cili pritet të nisë një aventurë të re në Londër, por me fanellë tjetër dhe jo të Chelseat. Në sezonin e kaluar me fanellën e Southamptonit në të gjitha kompeticionet, Armando Broja u aktivizua gjithsej në 38 ndeshje duke shënua 9 gola dhe duke dhuruar gjithashtu edhe një asistim.

De Ligt kalon te Bayerni

Matthijs de Ligt do të jetë një futbollist i Bayernit në sezonin e ri. Gazetari i "Bild", Christian Falk, raporton e Juventusit së fundmi ka pranuar ofertën e klubit "bavarez". Bëhet fjalë për shifrën e 70 milionë eurove, plus 10 milionë euro që do të vijnë në formë bonusesh. Bayerni ndërkohë ka përgatitur një kontratë deri në vitin 2027 për De Ligt, ndërkohë që në orët në vijim pritet të ketë edhe zhvillime të reja. "Bardhezinjtë" tashmë duhet të mendojnë për pasuesin e tij, teksa opsionet janë Bremer, Milenković dhe Pau Torres.

Ibra rinovonin kontratën me Milanin

Zlatan Ibrahimović ka rinovuar kontratën e tij me Milanin edhe për një vit. "Rossonerët" kanë lëshuar një njoftim në rrjetet sociale, duke

thënë se suedezi ka nënshkruar marrëveshje të re. "AC Milan ka kënaqësinë të njoftojë për rinovimin e kontratës së Zlatan Ibrahimovićit deri më 30

qershor 2023. Sulmuesi suedez do të vazhdojë ta mbajë fanellën me numrin 11", thuhet në njoftimin e tyre. Paolo Maldini dhe Frederic Massara

vizituan Ibrahimovićin në vilën e tij në liqenin Garda së fundmi dhe siguruan nënshkrimin e tij në marrëveshjen e re njëvjeçare. Sulmuesi do të fitojë

një pagë fikse prej rreth 1.5 milion eurosh neto në sezon, por bashkëngjitur janë bonuse që lidhen me asistimet, golat dhe objektivat.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenet 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 27.3 dhe 36 të Rregullores (ZKA) 02/2021 Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2022 (i ndryshuar/plotësuar), si dhe Vendimit të Auditorit të Përgjithshëm me Nr. 1312 të datës 18.07.2022 për plotësimin e vendeve të lira të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS

për plotësimin e vendeve të lira të punës

1. Pozita:	Auditor junior për auditim të performancës
Numri i referencës:	AJAP/ZKA/14-07/22
Grada:	ZKA-A8
Numri i pozitave:	Dy (2)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen auditime sipas planit vjetor, rregullave dhe metodologjisë së ZKA-së, Kodit të Etikës dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe raportin Drejtorit të Departamentit të Auditimit dhe udhëheqësit të ekipit të auditimit¹;
- Kryen hulumtime dhe analizë për fushën të caktuar dhe bën propozimin e temave audituese për planifikimin strategjik dhe atë vjetor të ZKA-së;(nën mbikëqyrje nga UA);
- Pjesëmarrje aktive në parastudim të auditimit në fusha të caktuara dhe deleguara nga UE;
- Ofron përkrahje profesionale duke kryer hulumtime dhe analiza të dhënave të mbledhura dhe prezantimin e tyre;
- Mbajtja e shënimeve dhe dokumentimi i intervistimit dhe gjetjeve tjera;
- Nxjerrja konkluzioneve dhe dhënia e rekomandimeve duke u mbështetur në dëshmitë audituese dhe në bazë të gjykimit profesional;
- Përgatitja e Letrave të punës me kohë së bashku me dëshmitë përkatëse dhe memo përmbledhës lidhur me auditimin e komponentës. fushës apo pyetjeve audituese, e cila i është caktuar;
- Indeksimi i letrave të punës dhe diskutimi me Udhëheqësin e tij/saj;
- Raportimi i vazhdueshëm të mbikëqyrësi lidhur me progresin e arritur në auditim;
- Aplikimi i punës online sipas kërkesave dhe udhëzimeve në nivel të zyrës për situata të caktuara;
- Kryen edhe detyra të tjera profesionale të kërkuara nga UEA dhe nga Drejtori i departamentit.

Kualifikimet Themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në hulumtim apo analiza, preferohet përvojë në auditim;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri në fushën e auditimeve;
- Shkathësi në organizim të punës dhe përmbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

2. Pozita:	Zyrtar për buxhet dhe financa
Numri i referencës:	ZBF/ZKA/15-07/22
Grada:	ZKA-C7
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon udhëheqësin e divizionit në organizimin e punës së përgjithshme, si dhe kujdeset për ndërmarrjen e veprimeve financiare të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
- Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të divizionit dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave;
- Përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve të domosdoshme për procesin buxhetor, kryen detyrën e zyrtarit zotues sipas LMFP-së;
- Menaxhon me parane e imët dhe avanset për ZKA-në, dhe përkujdeset që para ja e imët përdoret në përputhje me procedurat ligjore në fuqi;
- Ndihmon në menaxhimin e sistemeve përkatëse të buxhetit (Sistemi për Menaxhimin dhe Zhvillimin e Buxhetit-SZHM dhe Programi për Investime Publike-PIP) me qëllim të realizimit të pagesave dhe raportimit financiar, si dhe mbështet mbikëqyrësin në përgatitjen e raporteve periodike për ecuritë buxhetore;
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga Udhëheqësi i divizionit për Buxhet dhe Financa.

Kualifikimet Themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Dy (2) vite përvojë pune profesionale, preferohet përvojë të punës në planifikim dhe analiza.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë në fushën e në fushën e buxhetit dhe financave;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit);

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Kompensimi i pagës për pozitat e shpallura bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke filluar nga data 19.07.2022, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 03.08.2022 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Geo-Mineral" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën për prodhimin e betonit në Lapllasellë, Graçanicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.08.2022 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "MARIGONA" në rrugën "Metohijska" Nr.141 Mbrapa HIB Petollit i cili ndodhet 100 m nga rrethrotullimi i QMI-së, Graçanicë do të organizohet debat publik nga Kompania "Geo-Mineral" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën për prodhimin e betonit në Lapllasellë, Graçanicë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/7491688086?pwd=U05XRGMzcHpHRj10HhxdmNpUWJJCUT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Geo-Mineral" Sh.p.k Prishtinë për bazën për prodhimin e betonit në Lapllasellë, Graçanicë.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosova, članom 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (objavljeno u Službenom listu dana 16.09.2021); vezano sa članom 27.3 i 36 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji Radnih Mesta; Godišnjeg plana zapošljavanja za 2022. godinu (izmenjen/dopunjen), kao i Odluke Generalnog Revizora Br. 1312 datuma 18.07.2022, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS

za popunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Položaj: Revizor Junior za reviziju učinka;
Broj reference: AJAP/ZKA/14-07/22
Nivo: ZKA-A8
Broj radnih mesta: Dve (2)
Trajanje imenovanja: Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Sprovodi revizije u skladu sa godišnjim planom, pravilima i metodologijom NKR-a, Etičkim kodeksom i u skladu sa Međunarodnim standardima revizije i izveštava direktoru Departmana revizije i šefa revizorskog tima;
- Vršiti istraživanja i analize za određenu oblast i predlaže teme revizije za strateško i godišnje planiranje NKR (pod nadzorom VR);
- Aktivno učešće u pred-studijama revizije u određenim oblastima delegiranih od VT;
- Pruža stručnu podršku sprovođenjem istraživanja i analize prikupljenih podataka i njihovom prezentacijom;
- Vođenje beleški i dokumentovanje intervjuja i drugih nalaza;
- Donošenje zaključaka i davanje preporuka na osnovu revizorskih dokaza i na osnovu profesionalnog prosuđivanja;
- Pravovremena priprema radnih papira zajedno sa relevantnim dokazima i rezimeom memoranduma koji se odnosi na reviziju komponenti, oblasti ili pitanja revizije koja mu je dodeljena;
- Indeksiranje radnih papira i diskusija sa njegovim/njenim vođom;
- Kontinuirano izveštavanje kod nadzornika o napretku postignutom u reviziji;
- Primena rada online prema zahtevima i uputstvima na nivou kancelarije za određene situacije;
- Obavlja i druge stručne poslove koje zahteva VTR i direktor Departmana.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u istraživanju ili analize, poželjno iskustvo u reviziji;
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

Potrebne veštine:

- Značajno znanje iz oblasti revizije;
- Veštine u organiziranju rada i ispunjavanju objekta;
- Poznavanje važećih pravnih akata u Nacionalnoj kancelariji revizije;
- Znanja o efektivnom nadzoru nad profesionalnim radom;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Veštine motivacije i komunikacije u timu;
- Da poseduje dobre međuljudske veštine.

2. Položaj: Službenik za budžet i finansije;

Broj reference: ZBF/ZKA/15-07/22
Nivo: ZKA-C7
Broj radnih mesta: Jedno (1)
Trajanje imenovanja: Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže rukovodiocu divizije u organiziranju opšteg posla, kao i stara se o preduzimanju finansijskih radnji definisanih važećim zakonodavstvom;
- Izrađuje planove rada u skladu sa rukovodiocem za implementaciju zadataka definisanih na osnovu objekta divizije i daje preporuke u pogledu ostvarivanja objekta;
- Odgovoran za pripremu potrebnih dokumenata za budžetski proces, obavlja dužnost službenika za angažovanje prema ZUJFO;
- Upravlja sitnim novcem i avansima NKR-a, i osigurava da se sitni novac koristi u skladu sa važećim zakonskim procedurama;
- Pomaže u upravljanju relevantnim budžetskim sistemima (Sistem upravljanja i razvoja budžeta – SURB, i Programom javnih investicija-PJI) u cilju realizacije plaćanja i finansijskog izveštavanja, i podržava rukovodioca u pripremi periodičnih izveštaja o toku budžeta;
- Obavlja i druge zadatke po naređenju Rukovodilaca divizije za budžet i finansije.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva, poželjno radno iskustvo u planiranju i analizi.

Potrebne veštine:

- Znanje i iskustvo u oblasti budžeta i finansija;
- Veštine komunikacije i planiranja rada;

- Istraživačke, analitičke, evaluativne veštine i veštine formulisanja preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost ispunjavanja zadataka i rada pod pritiskom;
- Poznavanje rada na računarskim softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene položaje vrši se u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnom odlukom;
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dostavljeni dokumenti nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, počevši od 19.07.2022. godine, dok je rok za podnošenje dokumentacije 03.08.2022. godine do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručanju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Triumf Bytyqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

▶ Lejla Hoda shpall të humbur Vendimin për nostrifikimin e Diplomës Master të UEJL Tetovë.

▶ Violant Brati nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl.X, XI të Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

▶ Përparim Macuka nga Gjakova shpall të pavlefshme Diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakova.

▶ Besmir Fadil Grezda nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin identifikues ID 210652015 të U.P. "Haxhi Zeka" në Pejë drejtimi Juridik.

▶ Arianit Lleshi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII dhe diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

▶ Rreze Bokshi nga Gjakova, shpall të pavlefshme Çertifikatën e Maturës Shtetore Të Shkollës së Mesme të Mjekësisë " Hysni Zajmi" .

▶ Valmire Sfishta Bislimi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

▶ Valmire Sfishta Bislimi shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Bachelor të AAB-së, Prishtinë Edukim Mirëqenie Sociale.

▶ Halil Kurhasku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e SH.M.të Mjekësisë "Hysni Zajmi".

▶ Eriona Kameri shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Së njëmbëdhjet të Gjinnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë.

▶ Antifone Nixha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

▶ Dalina Hasani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, diplomën si dhe certifikatën e maturës shtetërore të shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

▶ Rexhep Bunjaku shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Së dhjetë të shkollës "Mehmet Akif".

▶ Shkumbin Shehu B.I. Emri tregtar: N.T.P. "Tre Yje Design" me NUI: 811485516 me seli në Prishtinë, Adresa: Rr. Ndue Perllushi, Pn Mati 1 shpall të pavlefshme Certifikatën e TVSH-se me numër të TVSH-së: 330032897 me datë të lëshimit: 18.09.2008 të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE		
Bilanci i gjendjes me : 30.06.2022 Euro'000		
	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Pasurite		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	7,467	11,498
Kërkesat ndaj bankave	1,403	2,028
Bonot e thesarit	-	-
Investimet në letra me vlerë	7,019	6,115
Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve	66,706	80,419
Patundshmëritë dhe pajisjet	1,625	1,527
Pasuritë e paprekshme	189	172
Pasuritë tatimore të shtyra	-	-
Pasuritë tjera	201	238
Gjithsej pasuritë	84,610	101,997
Detyrimet		
Depozitat e klientëve	63,791	75,059
Detyrimet ndaj bankave	4,006	16,080
Fondet tjera të huazuara	6,064	-
Detyrimet tatimore të shtyra	-	-
Detyrimet tjera	925	853
Gjithsej detyrimet	74,786	91,992
Ekuiteti i aksionarëve		
Kapitali aksionar	10,000	10,000
Rezervat e kapitalit	7	-
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake	504	504
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	321	509
Përbërësit tjerë të ekuitetit	-	-
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	9,824	10,005
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve	84,610	101,997

Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE		
Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 30.06.2022 Euro'000		
	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Të hyrat nga interesi	1,127	2,386
Shpenzimet e interesit	334	693
Neto të hyrat nga interesi	792	1,692
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	121	277
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	41	83
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet	80	194
Neto të hyrat nga tregtimi	3	9
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	-	-
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	285	765
Gjithsej të hyrat	591	1,131
Provizionet për humbjet nga kreditë	268	582
Provizionet tjera	2	3
Fitimi/(humbja) para tatimit	321	546
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	37
Shpenzimet e tatimit të shtyer	-	-
Fitimi/(humbja) neto	321	509
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	321	509

